



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	23.11.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Ambasadën e Shqipërisë
Përmes/Preko/Through:	Drejtoria së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtimit ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga Ambasada e Shqipërisë e cila për nderë të festës së Flamurit ka kërkuar shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Skënderbeu”, me qëllim të realizimit të shfaqjes artistike akrobatike “ Sfidë në Lartësi” me datë 25.11.2021 nga ora 18:00

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike nr.01-110-157481, i jep pëlqimin Ambasadës së Shqipërisë për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” me datë 25.11.2021 nga ora 18:00 për realizimin e shfaqjes artistike akrobatike “ Sfidë në Lartësi” sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.;
- Mos të pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve;
- Pas përfundimit të aktivitetit hapësira të kthehet në gjendjen e më parëshme.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.